



INSTITUTI
I HISTORISË
- Tiranë -

**ANALIZA VJETORE
BILANCI 2021 DHE
PERSPEKTIVA 2022**

Miratuar nga Këshilli Shkencor

INSTITUTI I HISTORISË

PËRMBLEDHJE

Instituti i Historisë (IH) vepron në kuadër të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) dhe angazhimet gjatë vitit 2021 janë të ndërlidhura, me aktivitete e veprimtari si njësi më vete dhe si pjesë e Akademisë. Në vlerësimin e përgjithshëm, gjatë vitit 2021 Instituti përmbushi të gjitha angazhimet institucionale dhe projektet e paraqitura nga studiuesit e tij, si dhe mori pjesë në aktivitete e projekte të tjera, të cilat pasurojnë produktin shkencor të IH, imazhin publik dhe bilancin e tij profesional.

Gjatë vitit 2021 kufizimet e COVID apo zhvillimet politike nuk arritën dot të zhvendosin vëmendjen nga debatet mbi historinë, mbi datat, simbolet, raportet tona me të kaluarën, me fqinjët apo me ndërkombëtarët. Historia vijon të jetë një fushë me interes të madh publik, ku përfshihen institucione të ndryshme kërkimore e shkencore si akademi, universitete dhe institute, por edhe politikanë e media. Megjithatë edhe këtë vit Instituti i Historisë dëshmoi se mbetet institucioni kryesor i studimeve dhe referencave profesionale mbi historinë.

- I. Gjatë këtij viti studiuesit tanë u angazhuan në përfundimin e **18 botimeve** përfshirë monografi, përmbledhje studimesh, akte konferencash, botime dokumentare si dhe ditarë për ngjarje të rëndësishme historike. Përveç tyre stafi kërkimor realizoi botime dhe projekte të tjera plotësuese, të cilat nuk ishin pjesë e kontratës bazë vjetore.
- II. Projekti ynë më i madh gjatë vitit 2021 ishte hartimi dhe publikimi i botimit shkencor **“Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX”**, vëllimi IV, ku janë angazhuar shumica e kërkuesve tanë shkencorë si autorë, redaktorë apo mbështetës. Botimi sapo ka dalë nga shtypi dhe me siguri do të shoqërohet me interes publik e profesional. Kolana e botimeve të tekstit të Historisë, ku bën pjesë edhe vëllimi IV, e cila përmbledh periudhën nga pavarësia tek fundi i Luftës II Botërore, sjell risi të shumta në metodologji, në stilin e shkrimit, në burimet referuese ku spikat larmia e dokumenteve arkivore, si dhe analizën objektive shkencore. Ndërkohë vijon puna për vëllimin V, i fundit i kolanës, i cili prek periudhën e regjimit komunist.
- III. Gjatë vitit 2021 një ekip studiuesish të Institutit vijuan kontributin e tyre profesional në tekstin sintetik **“Historia e Kosovës**, vëll. III dhe IV, projekt i Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Kosovë. Gjithashtu një pjesë janë angazhuar në **projektin e gjenocidit në Kosovë**, në kuadër të bashkëpunimit me të njëjtin institut.
- IV. Një pjesë e studiuesve të Institutit të Historisë janë ftuar dhe janë kontraktuar tashmë në ekipin e krijuar nga Akademia e Shkencave për të hartuar tekstin integral me tre vëllime të **Historisë së Shqipërisë**. Angazhimi i tyre nga viti 2021 dhe në vijim nuk lidhet me detyrimet vjetore në IH, por gjithsesi është pjesë e rëndësishme e kontributit profesional.

Lidhur me monografitë:

- Gjatë vitit 2021 u realizuan **4 monografi** në ASA dhe **1 jashtë saj** (A.Mema, A.Muhaj, Gj.Boriçi, E.Caka dhe A.Hoxha). 15 të tjera janë në proces kërkimor (disa në fazë finale), sipas kontratës midis kërkuesve, departamentit dhe dekanatit.
- Secili studiuës që po punon me monografitë e tjera në proces ka vijuar punën në dokumentet arkivore dhe trajtimin e aspekteve të veçanta të temës në referime në konferenca ose në botime brenda e jashtë vendit. Asnjë prej studiuësve nuk ka kërkuar shtyrje të afateve të paraqitjes së monografisë, ndërkohë që janë programuar dhe miratuar temat e reja të monografive për studiuësit që i mbaruan detyrimet e tyre gjatë vitit 2021.

Lidhur me pjesëmarrjet dhe referimet në konferenca shkencore:

- Gjatë vitit 2021 stafi kërkimor i Institutit realizoi **48 referime shkencore**, 24 në konferenca shkencore kombëtare dhe 24 të tjera në konferenca shkencore ndërkombëtare. Vlen të theksohet se të gjitha referimet në konferenca ndërkombëtare janë realizuar me kontributin dhe angazhimin direkt të studiuësve, pa mbështetje financiare nga ASA. Praktika të tilla vijojnë prej vitesh, por në të ardhmen do të jetë e domosdoshme që studiuësit të mbështeten financiarisht për të mundësuar pjesëmarrje dhe referime në konferenca të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat kanë impakt të madh në fushën kërkimore dhe në zgjerimin e lidhjeve me studiuës të vendeve të tjera.
- Angazhimi me referime në **24 konferenca shkencore brenda vendit** u jetësua përmes nismës së vetë Institutit (konferenca të organizuara nga Instituti), ose në bashkëpunim me institucione të tjera, sidomos AIDSSH, ISKK, QSHSA, IH në Kosovë etj.
- Në prill 2021 Instituti i Historisë organizoi konferencën shkencore **“100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021”**, me pjesëmarrje të gjerë të studiuësve të departamentit të Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar dhe atij të Historisë Bashkëkohore.
- Në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Kosovës u realizua në qershor 2021 konferenca **“Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë”**.
- Në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për arbëreshët, në nëntor 2021 u realizua konferenca shkencore **“Arbëreshët në fokusin e shtetit shqiptar”**. Punimet e të tre konferencave janë në proces vlerësimi për botim gjatë vitit 2022.

PËRMBLEDHJE E BOTIMEVE SHKENCORE GJATË VITIT 2021

Tabela përmbledhëse paraqet numrin e botimeve shkencore gjatë vitit 2022, të ndarë sipas kategorive të botimeve, si dhe sipas departamenteve. Në total, Instituti i Historisë realizoi 18 botime gjatë vitit 2021 (monografi, vëllime dokumentare, përkthime dhe akte konferencash), duke u konfirmuar Instituti me më shumë botime profesionale në ASA. Vëllimi i botimeve është produkt i kërkimeve shkencore të vazhdueshme dhe i angazhimit individual.

Në mënyrë përmbledhëse gjatë vitit 2021 studiuesit e Institutit të Historisë realizuan:

- I. 5 monografi dhe 11 botime dokumentare. 13 monografi janë në proces;
- II. 46 artikuj shkencorë brenda dhe jashtë vendit;
- III. 48 pjesëmarrje e referime në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

BOTIME DHE REFERIME	MONOGRAFI NË PROCES	BOTIME / DOKUMENTE	ARTIKUJ /KUMTESA SHKENCORE		REFERIME NE KONFERENCA	
			Brenda vendit	Jashtë vendit	Kombëtare	Ndërkombëtare
MESJETA	5 (2)	5	10	5	1	9
PAVARËSIA	6 (1)	5	11	2	8	5
BASHKËKOHORJA	7 (2)	1	13	5	15	10
TOTALI	18 (5)	11	34	12	24	24

MONOGRAFI TË PËRFUNDUARA (BOTUARA)

1. **Dr. Albana Mema** "Shteti dhe institucionet në Shqipëri 1920-1924" (e ndarë në dy pjesë), Tiranë: ASA, 2021.
2. **Dr. Ardian Muhaj** "Projekte kundërosmane në shek. XVI-XVII: Mes fantazisë, interesit dhe realitetit", Tiranë: ASA, 2021.
3. **Dr. Eduart Caka** "Vakëfet dhe funksioni i tyre në Shqipëri gjatë shekujve XVII-XIX", Tiranë: ASA, 2021
4. **Dr. Gjon Boriçi** "Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978" (Ribotim).
5. **Dr. Artan R. Hoxha:** "Tharja e Kënetës së Maliqit dhe ndërtimi i regjimit komunist në Shqipëri, Tiranë: Onufri, 2021.

MONOGRAFI NË PROCES

1. **Dr. Alvin Saraçi** *“Konsullata veneciane e Durrësit dhe tregtia me Venecian në shek. XVIII”*.
2. **Dr. Alvin Saraçi** *“Marrëdhëniet e Shqipërisë me Venecian dhe Triesten në periudhën moderne”*.
3. **Dr. Artan R. Hoxha** *“Shqipëria në vitet e tronditjeve të mëdha të sistemit (1960-1980)”*.
4. **Dr. Artan R. Hoxha** *“Kisha Ortodokse e Shqipërisë nën komunizëm (1945-1967)”* (në proces vlerësimi në KSH të Institutit).
5. **Dr. Edon Qesari** *“Prania italiane në fillesat e shtetit shqiptar (1914-1920)”*.
6. **Dr. Erjon Papagjoni** *“Komunitetet fetare: marrëdhëniet me shtetin dhe mes tyre (1920-1939)”*.
7. **Dr. Albana Mema** *“Emigracioni politik shqiptar në vitet 1925-1939”*.
8. **Dr. Gjon Boriçi** *“Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri 1944 – 1949”*.
9. **Dr. Hasan Bello** *“Arsimi dhe institucionet e huaja arsimore në Shqipëri (shek. XIX-1912)”*.
10. **Dr. Sali Kadria** *“Zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri (1928-1939)”*.
11. **Prof. Afrim Krasniqi** *“Shqipëria 1986-1992: nga izolimi absolut drejt një shoqërie të hapur”*.
12. **Prof. Beqir Meta** *“Minoritetet në Shqipëri 1925-1939”*, vëllimi dytë.
13. **Prof. Edmond Malaj** *“Shkodra në Mesjetë”*.
14. **Prof. Edmond Malaj** *“Shqiptarët dhe Republika e Raguzës në Mesjetë”*.
15. **Prof. Hamit Kaba** *“Shqipëria në orbitën e BRSS-së” 1945-1961”*.
16. **Prof. Ledia Dushku** *“Aspekte të pavarësisht, shtetformimit dhe shoqërisë shqiptare (1912-1914)”*.
17. **Prof. Romeo Gurakuqi** *“Shqipëria si pjesë e “hapësirës jetësore” perandorake të Italisë Fashiste, 1940-1943”*.
18. **Prof. Sonila Boçi** *“Nga rivalë në armiq: PKSH dhe Balli Kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore”*.

VËLLIME DOKUMENTARE / PËRMBLEDHJE / PËRKTHIME

1. **Dr. Hasan Bello:** *“Lufta e Shkodrës 1912-1913 (ditar anonim)”*, Instituti i Historisë.
2. **Dr. Hasan Bello:** *“Mbreti Zog dhe Fan Noli në dosjet e Sigurimit të Shtetit”*, Instituti i Historisë.
3. **Prof. Beqir Meta, prof. dr. Afrim Krasniqi dhe dr. Hasan Bello:** *“Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe arteve”*, vëllimi IV, me bashkautor, Instituti i Historisë.
4. **Prof. Edmond Malaj:** *“Hulumtime mbi historinë e Krishterimit në Shkodër e rrethina gjatë Mesjetës”*, Instituti i Historisë.
5. **Prof. Edmond Malaj:** *“Julius Pikso – Skënderbeu”* (Përkthim), Instituti i Historisë.
6. **Prof. Edmond Malaj:** *“Profile qytetesh dhe lokalitetesh mesjetare të Arbërisë Veriore”*.
7. **Prof. Ledia Dushku:** Aktet e Konferencës Shkencore *“Shqiptarët dhe ndërkombëtarët në vitet 1912-1926”*, organizuar nga Instituti i Historisë (ASA), Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë.
8. **Prof. Ledia Dushku:** Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare *“Ismail Qemal Vlora dhe elita politike shqiptare në procesin e shtetndërtimit”*, organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) dhe Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, shtator 2019.
9. **Prof. Marenglen Verli:** *“Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913)”*, vëll. I.
10. **Prof. Marenglen Verli:** *“Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1914)”*, vëll. VIII.
11. **Prof. Marenglen Verli:** *“Shqiptarët përballë sfidave të historisë”*, vëll. 1 dhe 2.

ARTIKUJ DHE KUMTESA SHKENCORE (BRENDA VENDIT)

1. **Dr. Albana Mema:** *“Kriza institucionale dhe karakteri i qeverisë së Fan Nolit”*, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2021.
2. **Dr. Alvin Saraçi:** *“Marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me Venecien me anë të portit të Durrësit në kapërcyell ndërmjet fundit të shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII”*, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2021.
3. **Dr. Alvin Saraçi:** *“Roli i konsullatës veneciane të Durrësit në mbrojtjen e interesave ekonomike të Venecias në fillim të shek. XVIII”*, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2020.
4. **Dr. Alvin Saraçi:** *“The role of the Venetian consulate of Durazzo in the protection of the economic interests of Venice at the beginning of the XVIII Century”*, në: *Albanian Studies*, vol. 2, nr. 2, viti III (VI), 2020.

5. **Dr. Ardian Muhaj** (në bashkautorësi Alban Lauka dhe Gjergj Bojaxhi): “Prejardhja e Fiseve Krasniqe e Nikaj nën Dritën e të Dhënave Gjenetike e Historike dhe Traditës Burimore”, në: *Studime historike*, nr. 3-4/2021.
6. **Dr. Artan R. Hoxha**: “From Red to White Sugar: The Collapse of Communism and the End of Autarkic Development in Albania”, *Albanian Studies* 2, 2 (2021): 65-92.
7. **Dr. Artan R. Hoxha**: “Shteti shqiptar dhe Arbëreshët e Italisë, 1920-1939: një diskutim paraprak”, *Continuum: revistë e studimeve arbëreshe*, 1 (2020-2021): 25-32.
8. **Dr. Artan R. Hoxha**: “Demonstratat në Kosovë në vitin 1981 dhe nacionalizmi i regjimi komunist i Tiranës – një analizë e shtypit shqiptar”, në: *Studime historike*, nr. 3-4/ 2021.
9. **Dr. Eduart Caka**: “Një vështrim i përgjithshëm i kontributit të vakëfeve tek medresetë në Shqipëri gjatë periudhës osmane”, në: *Studime historike*, nr. 3-4/2021.
10. **Dr. Erjon Papagjoni**: “Përpjekjet e para drejt ndërtimit të një shteti shekullar shqiptar”, në: *Studime historike*, nr. 3-4/2021.
11. **Dr. Gjon Boriçi**: “Fillimet dhe problemet kryesore të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, 27 nëntor 1944 - gusht 1945”. Në proces recensioni, në: *Studime historike*, nr. 3/4 2021.
12. **Dr. Gjon Boriçi**: “Përpjekjet e qeverisë shqiptare për të arritur industrializimin e vendit me anë të veprave të fundit madhore nga Kina në Shqipëri , 1966-1973”, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2021.
13. **Dr. Gjon Boriçi**: “Albania's failure to reach industrialization during the Cold War”, në: *Albanian Studies*, Dhjetor, nr. 2/2021.
14. **Dr. Gjon Boriçi**: “The “two China” theory in the Cold war era and the stand of Albania towards this matter”, në: *Albanian Studies*, Qershor, nr. 1/2021.
15. **Dr. Sali Kadria**: “Gjendja e rëndë ekonomiko-financiare e Shqipërisë dhe përpjekjet e qeverisë për sigurimin e një këshilltari financiar britanik (1921 –1922)”, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2021.
16. Prof. **Beqir Meta**: Shtetëzimi i shkollave private greke dhe reagimi i minoritetit, në: *Studime Historike*, nr. 1-2/2021.
17. **Prof. Edmond Malaj**: “Lufta anti-osmane dhe marrëdhëniet e Skënderbeut me Janosh Huniadin dhe të birin e tij Matias Korvinus”, në: *Studime historike*, nr. 3-4/2021.
18. **Prof. Edmond Malaj**: “Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare ndërmjet Raguzës dhe trojeve arbërore”, në: *Studime historike*, nr. 3-4/2021.
19. **Prof. Edmond Malaj**: “Trojet arbërore gjatë Mesjetës së hershme”, në: *Hylli i Dritës*, Shkodër, dorëzimi në dhjetor 2021.
20. **Prof. Hamit Kaba**: “Imperializmi amerikan ‘armik i përhershëm’ i regjimit komunist në Shqipëri”, në: *Profile të Armikut të Popullit në Diktaturë*, AIDSSH/FES (botim editorial).
21. **Prof. Hamit Kaba**: “Kosova në kryqëzime gjeopolitike: Shqipëria, Jugosllavia dhe Fuqitë e Mëdha 1945-1948”, në: *Studime historike*, nr. 1-2/ 2021.
22. **Prof. Ledia Dushku**: Kumtesa "The outbreak of the First world war and the process of migration in Southern Albania", në: *Albanian Studies*, 1/2021.

23. **Prof. Ledia Dushku:** “Nga të mandatuar në kohë lufte, në të zgjedhur në periudhë paqeje: një qasje krahasuese e tipareve të përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe Parlamentin e vitit 1921”, në: *Studime historike*, nr. 1-2 / 2021.
24. **Ledia Dushku:** Kumtesa “Figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe perceptimi për turqit osmanë në diskursin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës” (në proces recensionimi), në: *Studime historike*, nr. 3-4/2021.
25. **Prof. Marenglen Verli,** Kumtesa “Çështja e Kosovës në Parlamentin Shqiptar (1920-1924)”, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2021.
26. **Prof. Sonila Boçi:** “Situata politike në Shqipëri (tetor-dhjetor 1943): rezistencë, bashkëpunim e luftë civile”, në: *Studime historike*, nr. 1-2/2021.
27. **Prof. Sonila Boçi:** “Marrëdhëniet ndërmjet Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe Ballit Kombëtar gjatë muajve shtator-tetor 1943”, në: *Studime Muzeologjike*, nr. 11/2021.

ARTIKUJ SHKENCORË (JASHTË VENDIT)

1. **Dr. Alvin Saraçi:** “Il periodo d’oro delle relazioni commerciali di Scutari con la Repubblica (1757-1797)”, në: *Atti e memorie di Società Dalmata di Storia Patria*, 3° serie, n. 10, vol. XLIII, (2021).
2. **Dr. Alvin Saraçi:** “Il ruolo dei Bushati nel commercio del Pasciariato di Scutari (Albania) con la Repubblica di Venezia nella seconda metà del Settecento (1757-1797)”, në: *Atti e memorie di Società Dalmata di Storia Patria*, 3° serie, n. 9, vol. XLII, (2020).
3. **Dr. Artan Hoxha:** “From Missionaries of Socialism to Spies of Imperialism: The Shifting Position of Soviet Women in Communist Albania”, në *“Histories 1, 4 (2021): 256-266.*
4. **Dr. Hasan Bello:** “Kisha Katolike gjatë viteve të LDB”, në: revista *Kosova* (në proces botimi), Prishtinë.
5. **Dr. Sali Kadria:** “A view at the beginnings of Albanian-Yugoslav relations according to British diplomatic sources”, në: *Istorija 20. veka*, botim i Institutit të Historisë, Beograd.
6. **Prof. Afrim Krasniqi:** “Impact on Democracy of Emergency Measures Against Covid-19”, botuar në: *School of Advanced Study/ IALS Law Review* (University of London, UK.) Volume 8, pp 28-38, 21.03.2021.
7. **Prof. Afrim Krasniqi:** “Transition and political system issues in Albania” in: *Albania: 30 Years After Transition*, Jörg Baberowsky/ Afrim Krasniqi, në proces botimi, Campus Press, Germany.
8. **Prof. Afrim Krasniqi:** “The parliamentary administration: Case of Albania”, in: *Routledge Handbook of Parliamentary Administration* (libri pritet të botohet më 2022).
9. **Prof. Beqir Meta:** “Shteti shqiptar, minoriteti bullgar dhe Komiteti Bullgaro-Maqedon në vitet 1925-1939”, në: *Macedonian Review*.
10. **Prof. Edmond Malaj:** “Lezha in the Middle Ages”, in: *Studia Albanica*. Në proces botimi, dorëzuar në shtyp për botim tetor 2021.
11. **Prof. Edmond Malaj:** “Two previously unknown German monographs of the first half of the XIX Century on Scanderbeg's personalit”, in: *Studia Albanica*, 2/2019 (botuar në maj 2021).

12. **Prof. Hamit Kaba:** “Përplasja shqiptaro-sovjetike sipas pikëpamjeve politike greke”, në: *Greqia dhe Shqipëria në Luftën e Ftohtë, pikëpamje politike, ideologjike dhe mentalitetet*, Athinë: 2021, f. 117-143.

REFERIME NË KONFERENCA DHE TRYEZA KOMBËTARE

1. **Dr. Albana Mema:** Kumtesa “Zgjedhjet e 1921 dhe stabiliteti politik në Shqipërinë e fillim viteve 20”, në konferencën shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë, 21 prill 2021.
2. **Dr. Artan R. Hoxha:** “Nga periferia në periferi: shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe tranzicioni perandorak në Shqipëri e Ballkan”, në konferencën *The Lessons of History: Reflections on the 75th Anniversary of the End of WWII and the 30th Anniversary of the End of USSR*, mbajtur në Tiranë, 9 tetor 2021.
3. **Dr. Edon Qesari:** Kumtesa “Çështja kombëtare e shqiptarëve: një *by-product* i diplomacive habsburgase dhe italiane”, në tryezën e rumbullakët të organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar, Qendra kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Institutin e Historisë, Tiranë, 26 nëntor 2021.
4. **Dr. Eduart Caka:** Kumtesa “Mbi Librazhdin dhe krahinën e Çermenikës gjatë periudhës osmane” në Konferencën shkencore: *Çermenika dhe trevat e Librazhdit në regjistrat osman të viteve 1467, 1583 dhe 1642*, organizuar nga ASA dhe Bashkia Librazhd, *Librazhd, dhjetor 2021*.
5. **Dr. Gjon Boriçi:** Kumtesa “Kleri katolik shqiptar si imazhi simbol i perceptimit të armikut të popullit nga diktatura komuniste në Shqipëri”, mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: *Profile të armikut të popullit në diktaturë*, organizuar nga AIDSSH dhe ASA, Tiranë: Onufri, 2021.
6. **Dr. Gjon Boriçi:** Kumtesa “Ndërtesat dhe monumentet e komunizmit - utopia e kultit të betonit në realizmin socialist tek vendet ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore”, në: *Politikja*, nr. 2/2019, Tiranë: Jupiter Group, 2021.
7. **Dr. Sali Kadria:** Kumtesa “Shqipëria dhe rivaliteti italo-jugosllav gjatë viteve 1922-1923”, në konferencën shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë, 21 prill 2021.
8. **Dr. Sali Kadria:** Kumtesa “Profili i nacionalizmit shqiptar në kontekstin e Luftës së Dibrës gjatë viteve 1920-1921” në konferencën shkencore: *Lufta e Dibrës 1920-1921*, dhjetor 2021.
9. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Ritakimi i brishtë me institucionin e zgjedhjeve: risitë dhe problematikat e zgjedhjeve, në konferencën shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga IH/ASA, Tiranë, 21 prill 2021.
10. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Proletarë dhe kapitalistë? Paradokset e eksperimenteve ekonomike në vitet 1989-1990”, në konferencën shkencore: *Ekonomia socialiste në Shqipëri (1945-1990): baza ideologjike, dështimi dhe pasojat*, ISKK, Tiranë, 17-18.11.2021.

11. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Memoria dhe harta digjitale e vendeve të kujtesës në Shqipëri” referues në tryezat në AU, ULG dhe UT, organizuar nga ISP dhe ambasada e Çekisë, korrik 2021.
12. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Partitë politike në Shqipëri: baza ligjore, pritshmëria qytetare dhe sfidat kryesore të reformimit”, referim në tryezën në USH /UT, organizuar nga EU, korrik 2021.
13. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Reforma në drejtësi dhe procesi i integritetit”, in: *Justice Reform and Enlargement in SEE6*, CoE, tetor 2021.
14. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Roli i Kuvendit në procesin e integritetit”, in: *Democracy needs democratic parties*, KAS.
15. **Prof. Beqir Meta:** Fjalë hapjeje, Konferenca shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë, 21 prill 2021.
16. **Prof. Beqir Meta:** Kumtesa Konteksti ndërkombëtar i zhvillimit të Luftës së Dibrës, 1920-1921, në konferencën shkencore: *Lufta e Dibrës 1920-1921*, dhjetor, 2021.
17. **Prof. Hamit Kaba:** Kumtesa “Projekte amerikane për qeverisjen e Shqipërisë pas LDB”, në konferencën shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë, 22 prill 2021.
18. **Prof. Ledia Dushku:** Kumtesa “Nga të mandatar në kohë lufte, në të zgjedhur në periudhë paqeje: Aspekte të përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe zgjedhjet e vitit 1921”, në konferencën shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga Instituti i Historisë., Tiranë, 21 prill 2021.
19. **Prof. Ledia Dushku:** Kumtesa “Drejt mëvetësisë: Kuvendi Kombëtar i Vlorës dhe vendimet e tij”. Tryezë e organizuar nga Muzeu Historik Kombëtar, Qendra kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Institutin e Historisë, më 26 nëntor 2021.
20. **Prof. Romeo Gurakuqi:** Referat “Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore”: drejtimet kryesore të vendosjes së diktaturës dhe regjimit të terrorit, 1945-1992”, në: *4th International Summer Camp, Dealing with the aftermath of Communism. Learning for the future of Europe*, në Spaç/ Albania, August 27th - September 01st, 2021.
21. **Prof. Sonila Boçi:** Kumtesa “Vështrim analitik mbi fitoren e Frontit Demokratik në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945”, në konferencën shkencore: *100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921-prill 2021*, organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë, 21 prill 2021.
22. **Prof. Sonila Boçi:** Kumtesa “Marrëdhëniet e Tiranës zyrtare me arbëreshët e Italisë: një rast studimi mbi nacional-komunizmin shqiptar”, në konferencën shkencore: *Arbëreshët në fokusin e shtetit shqiptar*, organizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për arbëreshët në bashkëpunim me Institutin e Historisë.
23. **Prof. Sonila Boçi:** “Mbi memorien dhe vendet e kujtesës në Shqipëri”, referim në tryezën: *Memoria dhe harta digjitale e vendeve të kujtesës në Shqipëri*, ISP, ambasada e Çekisë në kuadër të programit TRANSITION, korrik 2021.

REFERIME / KUMTESA NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE (VENDET E BE/OECD)

1. **Dr. Ardian Muhaj:** Kumtesa "Naval power as a tool for measuring economic development: The pliography of the Ottoman commerce in the Adriatic in the Early Modern Age", mbajtur në: *12th International Symposium on Turkish Sea Trade*, organizuar nga Universiteti i Mesdheut, Antalja, Turqi, 10-13 nëntor 2021.
2. **Dr. Eduart Caka:** Kumtesa "Historical roots of religious coexistence in Albania", *Muslims in Southeast Europe: History, Indigenization and New Communities*, TWMCC Webinar Series, 17 April, Abu Dhabi/UAE.
3. **Dr. Gjon Boriçi:** Kumtesa "China's economic success in multilateral opening to the world and BRI", in: *Puttting People First and Global Human Rights Governance*, Pekin, Republika Popullore e Kinës. (Për shkak të pandemisë konferenca u zhvillua online). Konferenca u organizua nga South-South Human Rights Forum, Pekin, më 8 dhjetor 2021.
4. **Dr. Hasan Bello:** Kumtesa "Cooperation of Mustafa Kemal and Turkish nationalists with Albanians against Greeks (1920-1923)", në konferencën ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit të himnit turk (*İstiklal Marşının Kabulünün 100. Yılı Sempozyumu*), organizuar nga Universiteti Mehmet Akif Ersoj., Turqi, 28-30 tetor 2021.
5. **Prof. Edmond Malaj:** Kumtesa "Der antiosmanische Krieg und die Beziehungen zwischen Georg Kastrioti Skanderbeg und Johannes Hunyadi". Mbajtur në konferencën ndërkombëtare: *The Hunyadi and the Corvin Families*, Budapest, maj 2021.
6. **Prof. Romeo Gurakuqi:** Kumtesa "Albania in the Second World War and in the First Years of the Establishment of the Communists in Power", in: *The Treatment of Jews in Albania before and during the WWII*, Berlin, Germany.
7. **Prof. Romeo Gurakuqi:** Kumtesë në: *European Workshop on dealing with the past of Aushwitz burdened by violence, Oswiecim*, Poland, 2021 August 11-16.
8. **Prof. Sonila Boçi:** Kumtesa "Wind of changes reached Albania: regime's reluctant reforms and people's expectations", in: *La caduta del Muro e gli altri communism*, organizuar nga Universita Roma Tre dhe Fondazione "Marco Besso".

REFERIME NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE (VENDE JOANËTARE NË BE/OECD)

1. **Dr. Ardian Muhaj:** Referim në simpoziumin: *Balkans 2030. Challenges to Peace, Stability and Prosperity*, Shkodër, 19-20 nëntor 2021. Organizuar nga Instituti i Studimeve Politike "Sami Frashëri", Tiranë.
2. **Dr. Ardian Muhaj:** Kumtesa "The Greek Revolution and the Beginning of the End of the Arvanites and Arvanitism. Political Culturicide of an Autochthonous Population", në konferencën: *Roli i Arvanitasve në organizimin dhe fitoren e Revolucionit Grek*, organizuar nga Organizata Shqiptaro-Amerikane "Vatra" në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Shqiptaro-Amerikane e Arizonës" (AACC), më 22 maj, 2021.

3. **Dr. Artan R. Hoxha:** Kumtesa “Retorika nacionaliste dhe realpolitika internacionaliste: demonstratat studentore në Kosovë në vitin 1981 dhe kontradiktat e brendshme në ligjërimin e regjimit komunist të Tiranës”, në konferencën shkencore: *Pranvera shqiptare 1981 kthesë në historinë kombëtare*, organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Konferenca u mbajt në Prishtinë, më 26 mars 2021.
4. **Dr. Artan R. Hoxha:** Kumtesa “Pasqyrimi i revoltave kosovare të vitit 1981 në shtypin komunist shqiptar”, në konferencën shkencore: *Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” i Prishtinës dhe Instituti i Historisë i Tiranës. Konferenca u mbajt në Prishtinë, më 10 qershor 2021.
5. **Dr. Artan R. Hoxha:** Kumtesa “Të zgjedhim më të pastrit! Kategoritë identitare të kulluara komuniste dhe hibriditeti i arbëreshëve”, në *Arbëreshët në fokusin e shtetit shqiptar*, Tiranë, 19 nëntor 2021.
6. **Dr. Hasan Bello:** Kumtesa “Moderniteti dhe ideologjia në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane nga shek. XIX deri në fillim të shek. XX : Shqipëria dhe shqiptarët në tekstet e shkollave osmane”, në konferencën shkencore: *Mendimi historik në publicistikën shqiptare të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 23 qershor 2021.
7. **Dr. Hasan Bello:** Kumtesa “Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj demonstratave në Kosovë në vitin 1981”, në konferencën shkencore me rastin e 40-vjetorit të *Demonstratave të vitit 1981*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, Prishtinë, 26 mars 2021.
8. **Dr. Hasan Bello:** Kumtesa “Shtypi amerikan mbi ngjarjet në Kosovë në vitin 1981”, Konferenca me temë: *Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë. (bashkautor), Prishtinë, 10 qershor 2021.
9. **Prof. Afrim Krasniqi:** Kumtesa “Parlamentarizmi në tranzicion dhe mitet e përfaqësimit rasti i Shqipërisë pas 1990”, në konferencën shkencore: *Parlamentarizmi shqiptar ndër vite*, Universiteti i Prishtinës, Prizren, 11 qershor 2021.
10. **Prof. Beqir Meta:** Kumtesa “Shtypi amerikan mbi ngjarjet në Kosovë në vitin 1981”, në konferencën me temë *Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë. Prishtinë, 10 qershor 2021.
11. **Prof. Beqir Meta:** Kumtesa “Parlamenti dhe shtetndërtimi në Shqipëri në vitet 1920-1924”, në konferencën shkencore: *Parlamentarizmi shqiptar ndër vite*, organizuar nga Universiteti i Prishtinës, Prizren, 11 qershor 2021.
12. **Prof. Hamit Kaba:** Kumtesa “1979-1990: Politika e Jashtme e Shqipërisë përballë sfidave për ndryshim”, në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare (via zoom), *Albania 30 years after: The yoke of transition*, Instituti Shqiptar i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, AIIIS, June 21, 2021.
13. **Prof. Hamit Kaba:** Kumtesa “1981: Konteksti ndërkombëtar i demonstratave të Kosovës dhe rrjedhojat e tyre për Jugosllavinë”, në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: *Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë.
14. **Prof. Ledia Dushku** Kumtesa “Veprimtaria e arbëreshëve të Italisë në optikën e dokumentacionit austro hungarez (1895-1897)”, mbajtur në Kuvendin Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, organizuar nga Akademia e Shkencave, 24-28 nëntor 2021.

15. **Prof. Marenglen Verli:** Kumtesë në konferencën shkencore: *Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*, organizuar nga Instituti i Historisë, Prishtinë, 10 qershor 2021.
16. **Prof. Marenglen Verli:** Kumtesë në konferencën shkencore: *Parlamentarizmi shqiptar ndër vite*”, organizuar nga Universiteti i Prishtinës, Prizren, 11 qershor 2021.
17. **Prof. Romeo Gurakuqi:** Kumtesa “Një këndvështrim mbi jetën politike dhe parlamentare të Shqipërisë nga Kongresi i Lushnjës (1920) deri në Revolucionin e Qershorit 1924”. Konferencë Shkencore e organizuar nga Fakulteti Filologjik i Universitetit të Prishtinës dhe është botuar në Buletini i Fakultetit Filozofik, Prishtinë 2021.

REVISTA “STUDIME HISTORIKE” DHE “ALBANIAN STUDIES”

1. Ka përfunduar *Studime historike*, 1-2/2021 dhe 3-4/2021.
2. Ka përfunduar *Albanian Studies*, 1/2021 dhe është në proces botimi numri 2/2021.

Gjatë vitit 2021 vijoi përgatitja për botim e katër numrave të revistës shkencore *Studime historike*, të ndarë në dy numra, 1+2 në një botim dhe 3+4 në një botim të dytë.

- Në dallim nga viti 2020, stafi i redaksisë së revistës, me vendim të Këshillit Shkencor, u angazhua në ndryshime cilësore në formë dhe përmbajtje të revistës, për të aplikuar standardet e kërkuara ndërkombëtare të indeksimit të revistës.
- Të gjitha punimet kaluan përmes sistemit “**peer review**”, me abstrakt në anglisht dhe me një sistem të njësuar referimi, metodologjie dhe shkrimi.
- Revista ka nevojë për investim nga institucioni (ASA), për të **krijuar një faqe të dedikuar online**, si standard për praktikën e indeksimit. Kostoja financiare është minimale, por përfitimi profesional dhe publik është afatgjatë dhe i madh.

PROJEKTE DHE PREZANTIME

- I. Prezantimi i librit “*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*”, vëllimi IV, Panairi i Librit.
- II. Prezantimi i projektit “*Tirana në sytë e Sigurimit*”, me AIDSSH dhe bashkia Tiranë.
- III. *Harta e vendeve të kujtesës*, prezantim dhe debate në kuadër të ISP/ambasada e Çekisë.

BOTIME TË TJERA (JASHTË IH)

1. **Prof. Afrim Krasniqi** “*Dekriminalizimi: promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur*”, nëntor 2021.
2. **Prof. Afrim Krasniqi** “*Procesi zgjedhor 2021: për standarde më të lartë transparencë dhe integritet*”, 2021.

RECENSIONE VEPRASH SHKENCORE:

1. **Prof. Beqir Meta** “*Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*”, vëllim me kumtesa.
2. **Prof. Beqir Meta**, Ibrahim Gashi, *Vëllim me artikuj dhe kumtesa*.
3. **Prof. Beqir Meta**, Haxhi Ademi, Monografi - “*Kosova gjatë Luftë së Dytë Botërore*”.
4. **Prof. Romeo Gurakuqi** Recensent, autor i parathënies, “*Historia e Anglisë*”, Andre Maurois.
5. **Prof. asoc. dr. Sonila Boçi**, Memli Sh. Krasniqi, *Kosova (1981-1989): fillimi i shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë*, Prishtinë: Botimet Albanologjike, 2021.
6. **Dr. Artan Hoxha**: Theodora Dragostinova. *Cold War from the Margins: A Small Socialist State on the Global Cultural Scene*. Ithaca: Cornell University Press, 2021. 340 pp.

2021, NË INSTITUT U MBROJTËN KATËR DOKTORATURA

Gjatë vitit 2021 mbyllën punën kërkimore dhe realizuan me sukses mbrojtjen e temës doktrale katër doktorantë, punime të cilat janë realizuar për disa vite dhe kanë qenë pjesë e programeve kërkimore bazuar në ligjin e vjetër të Arsimit të Lartë. Konkretisht,

- “*Mehdi Frashëri si shtetar shqiptar (1913-1944)*”, *Valentina Hushi, me udhëheqës shkencor prof. Afrim Krasniqi*.
- “*Komunitetet fetare në Elbasan në vitet 1920-1939*”, *Nereida Shqerra (Omeri), me udhëheqës shkencor prof. Ledia Dushku*.
- “*Kosova si çështje ndërkombëtare në vitet 1941-1999 dhe qasjet ndaj saj*”, *Edval Zoto, me udhëheqës shkencor prof. Edmond Malaj*.
- “*Kosova gjatë viteve 1981-1999*” *Arbër Salihu, me udhëheqës shkencor prof. Ana Lalaj*.

Në studimet doktrale janë edhe dy tema ende në proces, për të cilat është parashikuar mbyllja e tyre gjatë gjysmës së parë të vitit 2022.

Pas miratimit të ligjit të ri të Arsimit të Lartë dhe akteve rregullatore, Institutit të Historisë dhe ASA nuk i është miratuar ende e drejta për të iniciuar studime të tjera doktrale. Ky kufizim e ka dobësuar punën kërkimore në Institut dhe në tërësi punën kërkimore në fushën e studimeve historike. Sfidat e ardhshme dhe ndryshimi i brezave të studiuesve, paraqet nevojën jetike që të ketë studiues të rinj me tituj shkencorë dhe që Instituti i Historisë, si qendra e vetme kombëtare e studimeve të thelluara historike, të ketë të drejtën e përgatitjes, zhvillimit dhe mbrojtjes së titujve doktrale.

ANGAZHIME PROFESIONALE TË STAFIT KËRKIMOR

- I. Një pjesë e stafit kërkimor të Institutit të Historisë është zgjedhur dhe angazhuar në stafin e **Akademisë së Shkencave në projektin për realizimin e një teksti integral të Historisë së Shqipërisë**. Angazhimi i tyre është individual, jashtë detyrimeve kontraktore në Institut, megjithatë është pjesë e kontributit shkencor dhe gjithashtu tregues i vlerësimit profesional të tyre.
- II. Disa anëtarë të stafit kërkimor të Institutit janë të përfshirë në **projektin e Institutit të Historisë në Kosovë** lidhur me gjenocidin përgjatë një shekulli dhe Historinë e Kosovës. Angazhimi i tyre është bazuar në meritat dhe ekspertizën profesionale, si dhe është tregues i vlerësimit dhe bashkëpunimit me institucionet homologe në Kosovë.
- III. Stafi kërkimor i Institutit është angazhuar në **10 komisione doktorature** në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji dhe universitete të tjera, duke qenë drejtues të komisionit, relatorë ose anëtarë. Angazhimi është i rëndësishëm sepse është vlerësim për studiuesit tanë, është pjesë e punës profesionale, si dhe tregues i bashkëpunimit me institucione të tjera shkencore dhe akademike në vend.
- IV. Anëtarë të stafit kërkimor në Institut janë të angazhuar **në grupe këshillimore dhe pune** në disa institucione, përfshirë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në Bankën e Shqipërisë, në bashkinë e Tiranës, në AIDSSH etj. Angazhimi i tyre përputhet me formimin shkencor dhe është tregues i njohjes e vlerësimit të ekspertizës së Institutit të Historisë nga institucionet tona shtetërore dhe publike.
- V. Një ekip i studiuesve të Institutit (Boçi, Bello, Boriçi, Hoxha) janë të angazhuar në një projekt bashkëpunimi me Autoritetin e Dosjeve, **“Tirana në sytë e Sigurimit”**, projekt që do të vijojë gjatë vitit 2022.
- VI. Një ekip studiuesish të Institutit (Meta, Krasniqi, Bello) janë të angazhuar në një projekt bashkëpunimi me fondacionin gjerman Konrad Adenauer, për botim periodik të vëllimeve me **dokumente mbi indoktrinimin** në kulturë, besimet fetare etj., gjatë periudhës komuniste.
- VII. Gjithashtu studiuesit e Institutit të Historisë janë angazhuar intensivisht në botime, prezantime, debate dhe prononcime në **medien e shkruar dhe vizive**, duke iu përgjigjur interesit të opinionit publik për çështje të ndryshme me natyrë historike.

ANGAZHIMI NË BASHKËPUNIME KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2021 Instituti u fokusua në lidhje më të forta bashkëpunimi me institute dhe qendra studimore në vende të ndryshme.

- Në listën e partnerëve mund të përmendim, **Institutin për Studimeve të Evropës Lindore në Gjermani, me institucione të njohura historike në Austri dhe ditët e fundit, edhe me Universitetin e Liverpulit në Britaninë e Madhe**. Dy studiues të IH kanë aplikuar dhe pritet të ketë angazhim në kuadër të Universitetit të Liverpulit, bazuar në marrëveshjen midis dy institucioneve. Paralelisht jemi në proces krijimi të një rrjeti shkëmbimesh dhe bashkëpunimesh me studiues të njohur të historisë në **ShBA, Austri, Britaninë e Madhe, Itali, Turqi, Greqi, Poloni, Hungari etj.** Në këtë drejtim synojmë të bëjmë pjesë të konferencave dhe projekteve tona edhe studiues shqiptarë që punojnë në universitete dhe qendra kërkimore evropiane dhe në ShBA.
- Gjatë 2021 Instituti i Historisë realizoi marrëveshje bashkëpunimi me **Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, si dhe me Muzeun Kombëtar**, për të vijuar promovimin e botimeve tona në partneritet me këto qendra/institucione.
- Instituti është pjesë edhe e **marrëveshjeve që ASA** ka nënshkruar, përfshirë memorandumit 2021-2026 të nënshkruar në dhjetor 2021 midis Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutit Albanologjik Prishtinë dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të shqiptarëve në Shkup, si dhe marrëveshjes specifike lidhur me programet e studimit, të realizuar nga ASA me Universitetin e Gjirokastrës.

PRIORITETET TONA KËRKIMORE GJATË VITIT 2022

- I. Gjatë vitit 2022, krahas punës me **monografitë individuale**, puna e studiuësve të Institutit të Historisë do të jetë e fokusuar në disa projekte botimi:
 1. *“Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX”*, Vëllimi V i kolanës.
 2. Vëllimet vijuese *“Historia e Kosovës”*, në kuadër të Institutit të Historisë në Prishtinë.
 3. Teksti sintetik *“Historia e shqiptarëve”*, projekt në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.
 4. Një cikël vëllimesh dokumentare mbi raportet e shtetit me komunitetet fetare gjatë periudhës së diktaturës 1945-1990, mbështetur nga fondacioni gjerman Konrad Adenauer.
 5. Në bashkëpunim me Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit dhe bashkinë e Tiranës nis jetësimi i projektit *Tirana në sytë e Sigurimit të Shtetit*.

- II. Fokusi ynë i dytë i rëndësishëm do të jenë organizimi dhe zhvillimi i **disa konferencave shkencore**, katër prej të cilave do të jenë ndërkombëtare:
 1. Konferencë shkencore ndërkombëtare në kuadrin e 110 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (nëntor 2022).
 2. Konferencë shkencore ndërkombëtare *“Shqipëria dhe SHBA, marrëdhëniet përgjatë një shekulli”* (shtator 2022).
 3. Konferencë shkencore ndërkombëtare *“Krijimi i shtetit të pavarur shqiptar dhe Austro-Hungaria: vështrim në retrospektivë”* (mars 2022).
 4. Konferencë shkencore ndërkombëtare *“Shqipëria dhe Britania e Madhe, marrëdhëniet përgjatë një shekulli”* (nëntor 2022).
 5. Konferencë shkencore *“50 vjet Instituti i Historisë”* (tetor-nëntor 2022).
 6. Konferencë shkencore *“Tipare dhe sfida të reja mbi trajtimin historik të Shqipërisë gjatë periudhës (1945-1990)”* (maj-qershor 2022).

Secila nga këto konferenca do të ketë thirrje për kërkuesit e interesuar dhe do të jetë e hapur për kontribute edhe nga institute të tjera në kuadër të ASA, si dhe natyrisht nga kolegët tanë studiues në Prishtinë dhe Shkup. Kemi programuar që krahas konferencave, për 3 prej tyre të sjellim në botim special dygjuhësh punimet profesionale të tyre, si dhe të përgatisim për botim edhe vëllime me dokumentet më të rëndësishme të këtyre marrëdhënieve.

- III. Në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Kosovë, me Universitetin e Shkodrës etj., do të ketë angazhime në **konferenca të përbashkëta shkencore** me fokus kërkimet shkencore mbi genodicin, kërkime shkencore mbi rolin dhe aktivitetin e Luigj Gurakuqit etj. Kalendarin e aktiviteteve të përbashkëta është ende në proces konsultimi.

- IV. Fokusi tjetër prioritar do të jetë revista **“Studime Historike”** për të vijuar përgatitjet dhe botimin me kriteret ndërkombëtare të indeksimit. Në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Prishtinë synojmë përgatitjen e një reviste të re të përbashkët studimore në gjuhën angleze.
- V. Fokusi i pestë ka të bëjë me zgjerimin e **bashkëpunimit ndërkombëtar**, duke synuar krahas konferencave të përbashkëta, edhe përgatitjen e botimeve me grupe autorësh për çështje specifike me rëndësi në historinë e shqiptarëve. Mbetet prioritare botimi i tyre edhe në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht.
- VI. Së fundi, në fokus mbetet **vijimi i kolanës së botimeve dokumentare** nga gjetjet në database arkivore të reja, kryesisht nga arkivi britanik, italian, austro-hungarez, turk etj., si dhe sjellja për publikun e kontributeve ende të papublikuara të fondit arkivor në Institutin e Historisë.

INSTITUTI I HISTORISË: INFORMACION DHE PROBLEMATIKA

Në këtë pjesë të raportit vjetor paraqiten kontribute të tjera plotësuese të Institutit të Historisë, si dhe problematika të ndryshme që lidhen me aktivitetin shkencor, me botimet, me pozitën ligjore dhe mjedisin kërkimor në Institut, si dhe me kushtet e punës së studiuesve. Instituti i Historisë nuk ka buxhet më vete, nuk ka administratë mbështetëse në Institut, por në dy rastet vepron në kuadër të buxhetit dhe administratës së ASA. Statusi është i njëjtë për të gjitha institutet.

STAFI KËRKIMOR I INSTITUTIT TË HISTORISË

Instituti i Historisë vijon të jetë instituti me më shumë botime (monografi dhe dokumente) në ASA, ndërkohë që është instituti i tretë në katër institute për nga numri i kërkuesve shkencorë.

- Gjatë vitit 2021 stafit kërkimor iu shtuan dy studiues, Artan R. Hoxha dhe Edon Qesari, të dy të diplomuar në universitete perëndimore, duke arritur në 18 kërkues shkencorë, numër që gjithsesi mbetet i vogël dhe i pamjaftueshëm për përballimin e volumit të punës për të gjitha periudhat historike.
- Për të përballuar të gjitha periudhat historike dhe për të pasur një angazhim më proporcional për to, Instituti i Historisë e ka jetike nevojën **për të zgjeruar numrin e studiuesve së paku për tri periudha, periudha e Bizantit, periudha otomane dhe periudha e Rilindjes Kombëtare**. Në konceptin tonë studimor është e pamundur që me numër kaq të kufizuar studiuesish, sidomos për periudhat e mësipërme, të arrijmë të përballojmë nevojën e kërkimeve të thelluara shkencore, ndërkohë që ndeshemi me kërkesat në rritje dhe aksesin në rritje në dokumente arkivore për to. Zgjerimi me personel kërkimor do të plotësonte kushtet minimale për të pasur kërkues shkencorë për secilën periudhë historike, si dhe do ta jetësonte në mënyrë më integrale dhe cilësore detyrimin ligjor që çdo departament në Institut të ketë 7 studiues në përbërje.
- Zgjidhja e problematikës afatgjatë për plotësim të numrit të kërkuesve shkencorë del jashtë kompetencave administrative të ASA dhe **kërkon strategji dhe mbështetje reale nga MAS dhe qeveria** për të investuar në përgatitjen e kërkuesve shkencorë të rinj në vende/gjuhë që janë jetike për studime mbi dokumentet arkivore historike të shtetit dhe kombit shqiptar, praktikë e cila nuk po zbatohet prej shumë vitesh.

PROBLEMATIKA INSTITUCIONALE NË KUADËR TË ASA

Problematika kryesore gjatë 2021 dhe në vijim mbetet statusi ligjor i Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) në raport me legjislacionin e ri të Arsimit të Lartë, me pretendimet e institucioneve të tjera dhe me vendimmarrjet e pushtetit ekzekutiv ndaj rolit, fushëveprimit, të drejtave dhe përgjegjësi të ASA. ASA është institucion me fokus kërkim shkencor dhe me numrin më të madh të studiuesve të përqendruar në Shqipëri. Vendimmarrjet e gabuara me sfond politik më 2015, kur u bë ligji i Arsimit të Lartë dhe mungesa e një legjislacioni të qartë për shkencën dhe aktivitetin shkencor në Shqipëri, ka çuar prej vitesh në vendosjen e ASA nën një presion politik të pamërituar dhe demotivues për kërkuesit e rinj.

Ndikime negative të gjendjes aktuale

- **Shkolla doktrate.** Vonesa e një vendimmarrje të plotë dhe të qartë nga MAS/KM për t'i siguruar status të veçantë ASA-s dhe për t'i dhënë të drejtën për promovime akademike dhe shkollë doktrale, dy standardet e institucioneve të njëjta në secilin prej vendeve të Bashkimit Evropian, ka ndikuar ndjeshëm edhe në aktivitetin e ASA.
- **Teksti i Historisë.** Ndikimet lidhen me kufizimin e të drejtave dhe përgjegjësi, me detyrimin që kërkuesit shkencorë të Institutit të Historisë të aplikojnë në institucione të tjera të arsimit të lartë për promovimin e tyre akademik, si dhe në krijimin e linjave paralele me sponsorizim politik edhe në fushën e historisë. Rasti më i fundit është projekti integral i historisë së Shqipërisë, i cili nuk i është besuar Institutit të Historisë, institucioni i vetëm profesional në fushën e studimeve historike, por i ka kaluar një institucioni tjetër, i cili nuk ka natyrë kërkimore shkencore, nuk ka staf kërkuesish dhe nuk ka përvojën dhe ekspertizën e duhur profesionale për një përgjegjësi të tillë.
- **Kufizimet në konkurrim / akses në projekte.** Mungesa e një akti të qartë dhe ligjor nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka ndikuar edhe në kufizimin e aksesit të Institutit të Historisë për të konkurruar në projekte të rëndësishme shkencore rajonale dhe më gjerë, për t'u mbështetur me fondet e duhura financiare për kërkim cilësor dhe të vazhdueshëm në arkivat e ndryshme të shteteve të tjera, si dhe për të luajtur rolin e institucionit lider në fushën e historisë, përfshirë edhe në aspekte sektoriale, siç është ekspertiza për tekstet shkollore.
- Impakt tjetër negativ është ndikimi i klimës së tensionuar dhe i paqartësive ligjore dhe administrative tek **fokusi i studiuesve për kërkime dhe botime shkencore.** Nëse vëmendja dhe burimet njerëzore janë të detyruara të merren me çështjen e statusit dhe bisedimet e pafundme me titullarët e MAS apo përfaqësues të tjerë të qeverisë dhe Kuvendit, atëherë koha e tyre akademike cenohet, presioni ndaj institucionit rritet dhe krijohet mjedis pune nën presion.

ELEMENTË TË TJERË SHQETËSUES PËR STAFIN

- **Transparenca institucionale.** Departamentet ritheksojnë nevojën që të gjitha organet e ASA të veprojnë sipas standardeve të programit të transparencës, përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, sipas të cilit çdo vendim i Senatit, Bordit, Rektoratit, Këshillit Shkencor etj., të publikohet në faqen zyrtare të Institutit ose të institucionit.
- **Mbështetja për kërkim në fondet e huaja dhe angazhime ndërkombëtare.** Disa studiuues të Institutit të Historisë kanë shprehur kërkesa të vazhdueshme për mbështetje financiare për kërkime të thelluara në arkivat e huaja dhe për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, të cilat janë detyrim për promovim akademik. Gjatë viteve të fundit këto kërkesa nuk kanë arritur të gjejnë mbështetje nga institucioni. Zgjidhja e kësaj problematike kërkon angazhim të ASA dhe përbën një nevojë jetike për kërkime cilësore dhe realizimin cilësor të misionit të Institutit të Historisë.
- **Botimet e Institutit të Historisë.** Praktika e punës me tenderat mbi botimet ka pamundësuar daljen e librave në kohë dhe sidomos ka pamundësuar pjesëmarrjen në Panairin e Librit me botimet më të reja. Gjithashtu firmat private realizuese kanë pasur cilësi të dobët pune, reflektuar kjo në cilësinë e botimeve të librave të Institutit. Për ne është thelbësore gjetja e një mekanizmi të qëndrueshëm institucional për botimin e librave në kohë (para muajit nëntor) dhe realizimi i tyre në cilësitë konkurruese me tregun e librit.
- **Shpërndarja e botimeve.** Kërkuesit shkencorë në Institutin e Historisë botojnë rregullisht 15-25 botime vjetore (monografi, vëllime dokumentesh, përmbledhje studimesh, përkthime etj.), megjithatë **botimet tona profesionale vijojnë të mos kenë një sistem shpërndarës cilësor dhe të qëndrueshëm.** Për shkak të kufizimeve financiare dhe pamundësia e institucionit për t'i trajtuar botimet me të njëjtin standard si entet e ndryshme botuese në vend, si dhe për shkak të vetë natyrës së botimeve, të cilat fokusohen tek interesi shtetëror, kombëtar e publik dhe jo tek marketingu mediatik, botimet tona nuk arrijnë të shkojnë tek lexuesit e duhur, në biblioteka dhe librari të frekuentuara nga qytetarë, të rinj, gazetarë apo studiuues me pasion e interes tek studimet historike.
- **Akresi i botimeve tona në nivel ndërkombëtar.** Numri i botimeve që depozitohet në biblioteka dhe institute homologe dhe me interes studimor në vende të ndryshme në Evropë apo në ShBA, është gjithashtu shumë i kufizuar dhe i ndërvarur nga marrëveshjet e shkëmbimit apo nismat individuale të vetë kërkuesve shkencorë. ASA ende nuk ka një sistem dhe as nuk ofron mundësi për këtë.
- **Akses institucional në botimet e reja ndërkombëtare.** Kërkuesit e Institutit vijojnë të sigurojnë në rrugë personale botimet e reja në fushën e historisë nga autorë të ndryshëm në vendet e tjera. Ky mekanizëm ka nevojë të rishikohet dhe vetë institucioni duhet të programojë fonde për blerjen dhe shkëmbimin e botimeve më të reja ndërkombëtare lidhur me historinë. E njëjta kërkesë vlen edhe për sigurimin e aksesit online për kërkuesit

shkencorë për të shfrytëzuar revistat, artikujt dhe botimet profesionale në qendrat kryesore kërkimore, sidomos në vendet perëndimore.

- **Trajtimi financiar i botimeve.** Nga ana tjetër, prej vitesh, për shkak të paqartësive ligjore dhe mungesës së mbështetjes buxhetore, kërkuesit shkencorë nuk përfitojnë honorare sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për veprat e tyre shkencore. Detyrimet financiare të institucionit ndaj kërkuesve shkencorë dhe stafit të angazhuar në vlerësimet / komisionet shkencore **janë të larta dhe vijnë të rriten**. Mungesa e tyre, kufizimet në statusin e institucionit, sistemi jofunksional i shpërndarjes dhe mungesa e një politike zyrtare mbështetëse për librin, kërkimin shkencor dhe historinë si fushë prioritare studimi, - janë faktorë demotivues për studiuesit, sidomos për studiuesit e rinj, si dhe për kërkuesit shkencorë të fokusuar 100% vetëm në veprimtari kërkimore shkencore.
- **Angazhimi në mësimdhënie.** Studiuesit e Institutit të Historisë përgjithësisht kanë pasur dhe kanë angazhime në mësimdhënie në institucionet e ndryshme të arsimit të lartë - një zgjedhje profesionale, por edhe kusht i rëndësishëm për promovimin akademik. Instituti dhe ASA do të duhet të angazhohen në marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë të sigurojnë akses në mësimdhënie edhe për studiues, të cilët, për shkak të periudhave specifike që mbulojnë, gjejnë vështirësi angazhimi.
- Nevoja për investim **në arkivin e Institutit.** Instituti ka një arkiv të pasur, i cili kërkon investime urgjente për të bërë **digjitalizimin e tij**, si mjet efikas për ta bërë më të përshtatshëm për studiuesit dhe bashkëpunëtorët shkencorë.
- **Pagesa për arkivat.** Një nga paradokset dhe shqetësimet e tjera, me të cilat përballen studiuesit e Institutit të Historisë, është detyrimi administrativ nga Arkivi Qendror i Shtetit dhe arkivat shtetërorë në Ministrinë e Jashtme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, sipas të cilit, çdo dokument i marrë në arkiv nga studiuesit tanë do të duhet të paguhet nga të ardhurat personale. Një marrëveshje dyvjeçare me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për të siguruar materiale arkivore falas në shkëmbim të botimeve të përbashkëta, u ndërpre në mënyrë të njëanshme nga ky institucion. Megjithatë për problematikën janë vënë në dijeni zyrtarisht organet përgjegjëse, përfshirë Këshilli i Ministrave, **ende nuk ka një trajtim dhe zgjidhje institucionale.** Për pasojë, Instituti i Historisë dhe institutet e tjera kërkimore në ASA janë të vetmet institucione kërkimore publike në Evropë që duhet të paguajnë tarifa financiare personale për çdo dokument të marrë nga arkivi shtetëror.

PROBLEMATIKA PËR T'U TRAJTUAR NË INSTITUT

- Në departamente është ngritur propozimi që të rishihet Rregullorja e Brendshme e Institutit të Historisë, neni 30 dhe 33, për saktësimin e procedurës që duhet të ndiqet për botimet

nën siglën e institucionit, të gjinisë së dokumenteve, kujtimeve, albumeve, përkthimeve etj, si dhe lidhur me miratimin e listës së botimeve të Institutit të Historisë. Gjithashtu duhet përfshirë përcaktimi i praktikës së ngarkesës vjetore në rastet kur drejtuesi kërkues shkencor është në pozitën e drejtorit të IH ose të rektorit të ASA.

- Praktika e punës së zyrës së Burimeve njerëzore **lidhur me lejet vjetore** duhet të ndryshojë, duke e përshtatur atë me Kodin e Punës, lidhur me të drejtën e stafit akademik për ta konsumuar lejen vjetore në çdo periudhë të vitit që ata e konsiderojnë të arsyeshme, jo në formën detyruese të përqendruar që është tani.

ZGJEDHJET NË INSTITUT DHE ASA, STAFI I RI DREJTUES

Instituti i Historisë u përfshi në procesin zgjedhor të zhvilluar në kuadër të ASA dhe zgjodhi drejtuesit e rinj. Të gjithë studiuesit morën pjesë në procesin zgjedhor, duke respektuar detyrimet ligjore dhe profesionale, dhe duke kontribuar në forcimin e komponentit të legjitimitetit në ASA.

- *Drejtor i Institutit u zgjodh prof. Afrim Krasniqi.*
- *Prof. Sonila Boçi u konfirmua përgjegjëse e Departamentit të Historisë Bashkëkohore.*
- *Prof. Ledia Dushku u konfirmua përgjegjëse e Departamentit të Historisë së Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar.*
- *Prof. Edmond Malaj u konfirmua përgjegjës i Departamentit të Historisë së Mesjetës.*
- *Prof. Hamit Kaba u zgjodh përfaqësues i Institutit në Senatin e ASA.*
- *Prof. Beqir Meta u zgjodh kryetar i Këshillit të Profesorëve në ASA.*
- *Dr. Albana Mema u zgjodh anëtare e Këshillit të Etikës në ASA.*
- *Dr. Sali Kadria vijon të ushtrojë mandatin e anëtarit në Bordin e Administrimit në ASA.*

Gjatë vitit 2021 stafi i Institutit të Historisë vijoi aplikimet për t'u promovuar në tituj shkencorë. Aktualisht, një kërkues me titullin, Profesor i Asociuar mori në tetor titullin Prof. Dr. në Universitetin e Tiranës, tre kandidatë të tjerë janë në proces shqyrtimi, si dhe tre doktorë të shkencave kanë aplikuar dosjet personale për t'u promovuar me titullin Profesor i Asociuar.

TË DHËNA PËR INSTITUTIN E HISTORISË

Stafi i Institutit të Historisë përbëhet nga dy akademikë, nga 8 profesorë, 10 doktorë shkencash dhe 3 asistues /persona mbështetës të aktivitetit studimor dhe botues.

	EMËR MBIEMËR	DEPARTAMENTI
1.	Akademik Prof. Dr. Beqir Meta	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
2.	Akademik Prof. Dr. Marenglen Verli	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
3.	Prof. Dr. Afrim Krasniqi	Dep. Historisë Bashkëkohore
4.	Prof. Dr. Hamit Kaba	Dep. Historisë Bashkëkohore
5.	Prof. Dr. Romeo Gurakuqi	Dep. Historisë Bashkëkohore
6.	Prof. Asoc. Dr. Edmond Malaj	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes
7.	Prof. Asoc. Dr. Ledia Dushku	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
8.	Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi	Dep. Historisë Bashkëkohore
9.	Dr. Albana Mema	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
10.	Dr. Alvin Saraçi	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes
11.	Dr. Ardian Muhaj	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes
12.	Dr. Artan Hoxha	Dep. Historisë Bashkëkohore
13.	Dr. Edon Qesari	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
14.	Dr. Eduart Caka	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes
15.	Dr. Erjon Papagjoni	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
16.	Dr. Gjon Boriçi	Dep. Historisë Bashkëkohore
17.	Dr. Hasan Bello	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes
18.	Dr. Sali Kadria	Dep. i Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar
19.	Mimoza Konomi (specialiste)	Dep. Historisë Bashkëkohore
20.	Ma. Mirela Mihali (specialiste)	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes
21.	Ma.Ornela Haka (specialiste)	Dep . i Mesjetës dhe Rilindjes

ASA AKORDOI TRE VLERËSIME PËR KARRIERËN NË INSTITUT

- Gjatë vitit 2021 me propozim të Institutit të Historisë, ASA aplikoi akordimin e çmimit të mirënjohjes për studiues me kontribut jetësor në ASA, me rastin e daljes së tyre në pension. Nga Instituti i Historisë u nderuan prof. Ana Lalaj, prof. Pëllumb Xhufi dhe prof. Fatmira

Musaj, të cilët kanë kontribuar për vite të tëra në Institut, angazhim që e vijojnë edhe pas daljes në pension gjatë dy viteve të fundit. Praktika e nderimit me mirënjohje për stafin kërkimor dhe administrativ, me rastin e daljes së tyre në pension, do të vijojë edhe gjatë viteve në vijim, duke krijuar një traditë pozitive institucionale.

- Në dhjetor 2021 Presidenti i Republikës nderoi me medalje të lartë për aktivitetin shumëvjeçar kërkimor në fushën e studimeve historike, prof. dr. Marenglen Verlin, kërkues shkencor prej disa dekadave në Institut, ish drejtor dhe më vonë edhe rektor në ASA.